

Për: Drejtorinë e planifikimit dhe urbanizmit të komunës së Prishtinës

Nga: Banorët që jetojnë në lagjen Mati 1, rruga Mitrush Kuteli

Tema: Ankesë në kushtet për ndërtim të propozuara nga investitori “Brajshori”

I/e nderuar

Kjo ankesë ndërlidhet me kushtet e propozuara për ndërtim në parcelat 535-2, 535-7, 535-8 dhe 506-1 në të cilat parashihet të ndërtohet objekt kolektiv me etazhitet B+S+P+6.

Konsiderojmë se kemi arsye të besojmë se kushtet e propozuara për ndërtim nga investitori bien ndesh me kushtet që lejohen përmes Planit rregullues urban për Matin 1:

- Përgjigja se objekti do të ketë qasje të pakufizuar në rrugë publike nuk qëndron sepse sipas Planit rregullues urban për Matin 1 nuk është paraparë rrugë e planifikuar e cila do t'i mundësonte këtij objekti qasje në rrugë. Rruga e vetme e planifikuar në këtë lagje është ajo përgjatë përroit (rruga D), por që investime në rregullimin e saj ende nuk ka. Rruga ekzistuese Mitrush Kuteli sipas regjistrit kadastral nuk ka gjerësi të mjaftueshme dhe nuk përmbush standardin optimal për rrugë për banim kolektiv. Fotoja në vijim tregon gjerësinë e rrugës e cila sipas kadastrit figuron si rrugë publike e që në hyrje të saj është vetëm **2.7m'**, dhe më tutje është 2.8m', 2.5m', 3.1m' pra në asnjë rast nuk kalon as 4m'. Gjerësia e rrugës ekzistuese nuk është e mjaftueshme për të realizuar edhe grumbullimin e mbeturinave me kamionë që marrin mbeturinat nga kontinjerë. Aktualisht grumbullimi i mbeturinave bëhet me kamionetë të vegjël që mbledhin mbeturinat nga shportat jo kontenierë.
- Rruga Mitrush Kuteli nuk ka trotuare dhe as që ka mundësi të ketë në të ardhmen, sepse të gjitha pronat janë private dhe sa jemi në dijeni ende nuk është bërë ndonjë projekt i eksproprijimit të pronave private për troturare.



- Konsiderojmë se me koeficient ndërtimi prej **1.8** nuk mund të arrihet etazhitet me 7 etazhe mbi tokë plus suterren. **Pra tejkalohen parametrat e Planit të reviduar.** Në kushtet e propozuara nuk është prezantuar sipërfaqja totale e paracelës për zhvillim, prandaj dyshojmë se mund të ketë gabime apo manipulim me arritjen e etazhitetit të tillë me këtë koeficient.
- Rrjeti i kanalizimit është zhvilluar me investime vetanake të banorëve dhe nuk përmbush standardin për të përballuar një ngarkesën e kanalizimit për banim kolektiv, për më shumë ai përfundon në pronë private.
- Rrjeti i ujësjellësit është zhvilluar me investime vetanake të banorëve rezident e jo nga komuna, prandaj ne nuk pranojmë që ky ndërtim të ketë qasje në rrjetin ekzistues sepse ky rrjet nuk ka kapacitetin e mjaftueshëm ta përballojë një ngarkesë të tillë;
- Prezantimi I objekteve me ngjyrë të kaltër gjoja se do të jenë banesa kolektive, nuk qëndron sepse nuk janë të gjithë banorët të pajtimit për të lëshuar pronat e tyre për banesa.

Nga drejtoria e urbanizmit kërkojmë që të shqyrtojë me kujdes kushtet e propozuara nga investitori karshi ankesës tonë. Duam sqarim nga ju se si është menduar zgjerimi i rrugës Mitrush Kuteli për t'u përcaktuar si rrugë publike me standard optimal. Nëse ka ndonjë projekt për këtë, duam të kemi qasje në të apo leje ndërtimi nëse ka.

Kërkesa e dytë është të na siguronim elaborim të saktë dhe të kuptueshëm se si është arritur etazhiteti prej 7 katesh me koeficient ndërtim 1.8.

Ju bëjmë me dije se kjo nuk është e vetmja ankesë në lidhje me dhënien e kushteve të ndërtimit në mos-përputhje me Planin rregullues. Banorët e kësaj lagje dhe lagjes në afërsi kanë deponuar ankesa edhe më herët pikërisht për të tilla kushte jo-konform planit.

Banorët e nënshkruar: